



2
0
2
4

BULETINI

GUSHT



Qytetarë të shumtë shijuan një atmosferë të jashtëzakonshme në koncertin festiv të Mërgata Fest & Sports , i cili po vazhdon me muzikë të zhanreve të ndryshme nga këngëtarë të mirënjohur.

Në sheshin 'Adem Jashari' në qytetin e Lipjanit, qytetarë të shumtë ishin pjesë e festivalit të organizuar për nder të mërgatës tonë, me mbështetjen e Kryetarit të Komunës, z. Imri Ahmeti, në kuadër të koncertit festiv 'Mërgata Fest & Sports'.

Sonte, sheshi i qytetit ishte i mbushur me qytetarë duke shijuar performancën e këngëtarëve të mirënjohur të estradës dhe të komunës së Lipjanit, si: Nora Istrefi, Donjeta Morina, Flamur & Ilir, Cha Cha Darabuka , Tajson Flow, Andi Sylejmani, Nimi Bytyqi, Blerona Zeqiri dhe Dj Nity .



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, priti në një takim përfaqësuesit amerikanë nga Shteti i New York-ut, z. David Carr, anëtar i Këshillit të Shtetit të New York-ut, z. Charles D. Fall, anëtar i Asamblesë së Shtetit të New York-ut, dhe veprimtarin e njohur, z. Naser Nika.

Kryetari Ahmeti fillimisht shprehu mirënjohjen e tij të thellë për përfaqësuesit e Shtetit të New York-ut për vizitën e tyre në Komunën e Lipjanit. Ai theksoi se miqësia mes Kosovës dhe Amerikës është një lidhje e thellë dhe e veçantë, e cila vazhdon të forcohet dhe të çmohet.

“Fillimisht dua t’ju falënderoj për vizitën tuaj në Komunën e Lipjanit. Kosova është ndërtuar falë mbështetjes së palëkundur të Amerikës, dhe ne do të jemi gjithmonë mirënjohës për këtë mbështetje, andaj çdo vizitë e juaja është një nder, privilegj për mbështetjen e vazhdueshme që kemi nga SHBA-të,” tha Kryetari Ahmeti.

Ndërsa, përfaqësuesit e Shtetit të New York-ut shprehën falënderimet e tyre për mikpritjen e ngrohtë nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti. Ata theksuan se vizita e tyre në Kosovë është pjesë e një misioni që forcon lidhjet e tyre me shqiptarët e Kosovës dhe u mundëson një njohje më të thellë me kulturën tonë. Sigurisht që kjo njohje do të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve që kemi me komunitetin shqiptar në New York.

Në përfundim të takimit, Kryetari Ahmeti nderoi përfaqësuesit e Shtetit të New York-ut me pllakatat e stemës së Komunës së Lipjanit, si një shenjë respekti për vizitën e tyre në Komunë e Lipjanit.



Nata e dytë e festivalit "Mërgata Fest & Sports" vazhdoi me një atmosferë fantastike, të mbushur me energji dhe argëtim nga bashkatdhetarët tanë të dashur dhe qytetarët e Lipjanit, të cilët e transformuan sheshin "Adem Jashari" në një natë të paharrueshme të këtij festivali.

Atmosfera fantastike u krijua nga performancat e këngëtarëve të mirënjohur të estradës dhe të Lipjanit, të cilët i dhanë Lipjanit një pamje fantastike, si: Rovena Stefa, Blleki, Korab Shaqiri, Festimi, Blerona Zeqiri, dhe DJ Nity.



Nata finale e Mërgata Fest & Sports mbushi me qytetarë të shumtë sheshin 'Adem Jashari' në qytetin e Lipjanit.

Java e festës për bashkatdhetarët tanë përfundoi me një koncert festiv që, për tri ditë me radhë, solli në qytetin e Lipjanit emra të njohur të këngëtarëve të estradës sonë dhe të qytetit të Lipjanit, të cilët na argëtuan pa masë me këngët e tyre.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka shprehur falënderimet e tij për të gjithë qytetarët e Lipjanit, veçanërisht për bashkatdhetarët dhe të rinjtë, të cilët ishin të mrekullueshëm gjatë gjithë këtyre netëve festive.

Plot një javë, në kuadër të festivalit Mërgata Fest & Sports, u organizuan aktivitete të shumta në sporte të ndryshme, ku qytetarët tanë, përveç argëtimit, patën mundësi të socializohen më shumë dhe të garojnë në disiplinat e ndryshme.

Ky festival, tashmë tradicional për Komunën e Lipjanit, u përmbyll me një koncert festiv, në të cilin performuan këngëtarë të mirënjohur si Shkurte Fejza, Shpat Kasapi, Alban Mehmeti, Gresa Behluli, Tajson Flow, Mega Robot Show, Blerona Zeqiri dhe DJ Nity.



Konferenca Rinore për Ditën Ndërkombëtare të Rinisë Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me organizatën YAHR, organizoi një Konferencë Rinore në kuadër të Planit të Veprimit për Rini.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, theksoi rëndësinë e mbështetjes për të rinjtë dhe ndikimin e saj të rëndësishëm në zhvillimin e vendit tonë.

"Ne kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur dhe integruar të rinjtë tanë në politikat qeverisëse, me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje. Prandaj jemi komuna e parë që mbështet financiarisht Planin e Veprimit për Rini si dhe përmes projekteve të ndryshme, mbështesim të rinjtë dhe promovojmë idetë dhe kërkesat e tyre," tha nënkryetari Bytyqi.

Konferenca Rinore, e organizuar sot në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, që shënohet më 12 gusht, ka për qëllim të mbledhë të rinjtë e Komunës së Lipjanit për të diskutuar mbi objektivat dhe prioritetet që ata i konsiderojnë si më të rëndësishmet.



Shënohet Dita e Rinisë në Lipjan me koncertin festiv “Rinia Fest”

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport organizon koncertin “Rinia Fest” në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, një natë e jashtëzakonshme me muzikë dhe energji të paharrueshme.

Për nder të Ditës së Rinisë, sheshi “Adem Jashari” u shëndrrua në një atmosferë fantastike nga të rinjtë e Lipjanit, të cilët me energjinë e tyre e bënë këtë koncert të paharrueshëm.

Në Koncertin “Rinia Fest”, përformuan këngëtarët e mirënjohur të estradës dhe të Komunës së Lipjanit, si: Adelina Berisha, Asim Gashi, Ajla Jakaj, Bardha & Emir Drnogllava dhe DJ Niti, të cilët krijuan një atmosferë fantastike për të rinjtë lipjanas.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti dhe përfaqësuesi nga Democraci Plus (D+) z. Valmir Ismaili kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit për themelimin e “Ekipit Auditimit Social” në projektet “Ndërtimi i Çerdhes në Rufc të Ri faza e II dhe “Ndërtimi Sallës së Sporteve në Shkollën Ismail Luma në Lipjan”, projekte këto nga granti i performances komunale (DEMOS) mbështetur nga programi për Decentralizim dhe përkrahje të Komunave Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia Helvetas zbatuar nga Swiss Intercooperation në Kosovë.

Kryetari Imri Ahmeti, ka falënderuar projektin DEMOS për bashkëpunimin si dhe përfaqësuesve të Democraci Plus (D+) u ka ofruar mbështetje në realizimin e këtij projekti, në të njëjtën kohë Kryetari Ahmeti ka ftuar qytetarët lipjanas që të jenë sa më aktiv në procesin e auditimit social për të shtuar edhe më tutje transparencën dhe llogaridhënien institucionale.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z.Imri Ahmeti i shoqëruar nga Drejtori i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, z.Shkelzen Hajdini kanë pritur sot përfaqësuesin e Kompanisë Medica z.Ardian Ukelli me të cilin kanë nënshkruar Marrëveshje për Bashkëpunim për dhurimin e pajisjes mjekësore Mamografit Digjital si donacion nga Kompania Medica për Komunën e Lipjanit përkatësisht për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan.

Kryetari Imri Ahmeti, ka falenderuar Kompaninë Medica për donacionin e Mamografit Digjital për QKMF-në në Lipjan, pajisje kjo e cila do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve.



Filloi organizimi i dëgjimeve buxhetore për Planifikimin e Buxhetit për periudhën 2025-2027

Komuna e Lipjanit ka nisur organizimin e dëgjimeve buxhetore për Planifikimin e Buxhetit për periudhën 2025-2027. Këto takime janë thelbësore për përcaktimin e projekteve dhe investimeve që do të realizohen gjatë kësaj periudhe, duke u bazuar në nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, theksoi rëndësinë e këtij procesi, duke potencuar se planifikimi i buxhetit është një nga shtyllat kryesore të qeverisjes lokale, pasi përcakton mënyrën se si do të investohen fondet në projekte që kanë për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Takimet e para u mbajtën me përfaqësues të Asamblesë Komunale, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, si dhe me komitete të tjera. Më pas, diskutimet u zgjeruan me grupe të ndryshme interesi, përfshirë gratë dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat rinore, klubet sportive, fermerët, qytetarët e qytetit të Lipjanit dhe kryetarët e këshillave të fshatrave.

Këto dëgjime kanë për qëllim krijimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, ku secili qytetarë ka mundësinë të kontribuojë në përcaktimin e prioritetëve të projekteve që do të realizohen në të ardhmen.



Takimet e dëgjimeve buxhetore për Planifikimin e Buxhetit për periudhën 2025-2027 kanë vazhduar edhe në fshatin Gadime, me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani, prezantoi buxhetin e Komunës së Lipjanit para qytetarëve të Gadimes, duke u bërë thirrje qytetarëve pjesëmarrës që të parashtrojnë kërkesat e tyre për t'u përfshirë në planifikimin e buxhetit komunal.

Gjatë këtij takimi, qytetarët e Gadimes shprehën kërkesat e tyre, të cilat ndërlihen drejtpërdrejt me nevojat specifike të fshatit



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Rozeta Hajdari.

Kryetari Ahmeti dhe Ministrja Hajdari u zotuan për investime të përbashkëta në Zonën Ekonomike të Qylagës, me qëllim vendosjen e bizneseve që do të gjenerojnë vende të reja pune.

Ky memorandum ka për qëllim zhvillimin e infrastrukturës në fazën e pestë, e cila do të krijojë hapësira industriale moderne për vendosjen e bizneseve. Investimi në infrastrukturën e kësaj zone, ka për synim krijimin e kushteve të përshtatshme për investitorët, e cila është me rëndësi të veçantë.

Zona Ekonomike e Qylagës ofron një mundësi të jashtëzakonshme për investim, falë pozicionit të saj strategjik pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe afërsisë me dy autostradat kryesore të vendit, kjo e bën atë një nga lokacionet më të favorshme për investime nga investitorët e ndryshëm.



Komuna e Lipjanit po vazhdon procesin e degjimeve buxhetore për periudhën 2025-2027, me qëllim përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve në planifikimin e buxhetit.

Këto degjime përbëjnë një hap të rëndësishëm për të siguruar që kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve të jenë pjesë e planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit.

Drejtori i Financave z. Latif Ramadani, theksoi rëndësinë e këtyre degjimeve, duke i cilësuar si thelbësore për të siguruar që planifikimi i buxhetit të reflektojë prioritetet e qytetarëve.

Dëgjimet janë mbajtur në fshatrat Ribar i Madh dhe Shalë, ku qytetarët kanë pasur mundësinë të shprehin opinionet dhe propozimet e tyre. Ndërsa nesër, takimi do të vazhdojë në fshatin Grackë e Vjetër.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, priti në takim nxënësin Jeton Sylejmanin, një talent të shkëlqyer në fushën e shkencës dhe matematikës


Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti pati kënaqësinë të njoh më nga afër Jeton Sylejmanin, nxënësin e klasës së 5-të nga shkolla fillore "Vëllezërit Frashëri" në Konjuh. Jetoni përfaqësoi Kosovën me dinjitet të madh në dy ngjarje ndërkombëtare prestigjioze, ku tregoi talentin e tij të jashtëzakonshëm dhe përkushtimin ndaj dijes.

Kryetari Ahmeti theksoi se këto arritje madhështore janë dëshmi e talentit të tij dhe një shembull i shkëlqyer për të gjithë bashkëmoshatarët e tij. Ai e uroi Jetonin për sukseset e tij dhe i ofroi mbështetje të plotë në rrugën e tij të mëtutjeshme drejt njohurive dhe përparimit të tij në fushën e dijes.

Jetoni arriti të rrëmbejë jo më pak se katër Medalje të Artanë kategoritë e matematikës dhe shkencës, në garën prestigjioze NEO Science Olympiad të mbajtur në New York të SHBA-së, dhe në Olimpiadën STEM në Hagë të Holandës. Ai u shpall "Best of the Best" mes nxënësve të klasës së 5-të nga mbi 30 vende pjesëmarrëse, duke ngritur lart emrin e Kosovës dhe të Komunës së Lipjanit.

Në përfundim të takimit, Kryetari Ahmeti i dhuroi Jetonit stemën e Komunës së Lipjanit si shenjë mirënjohjeje për përfaqësimin dinjitoz dhe suksesin e arritur.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë